



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
SEKTORI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE, LETRAVE DHE PLATFORMËS
SË BASHKËQEVERISJES

Nr.7320/1prot.

Tiranë, më 04.08.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Z. A. Xh.

Adresa: Lakanas i Ri,

Tiranë.

Në përgjigje të kërkesës suaj me nr. prot. 7320, datë 31.07.2025, ju informojmë si më poshtë:

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 551, datë 08.11.1993, “Për lejimin e pagesës së pensionit të pleqërisë për pensionistët e punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat”, përcaktohet se:

1. Lejohet pagesa e pensionit mujor të pleqërisë për pensionistët që, pas daljes në pension, punësohen ose vetëpunësohen në sektorin privat.
2. Pensionistët e punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat janë të detyruar të derdhin kontribute për sigurimet shoqërore, në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të VKM nr. 77, datë 28.01.2015, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, gjatë gjithë kohës që përfitojnë pension.
3. Kontributet e derdhura gjatë kësaj periudhe nuk njihen si vjetërsi pune për efekt të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, dhe nuk merren në konsideratë për rilogaritjen apo rishikimin e masës së pensionit.

Gjithashtu, neni 15/1 i ligjit nr. 7703, të ndryshuar, dhe VKM nr. 77, të ndryshuar, përcaktojnë se:

“Përfashtohen nga detyrimi për të paguar kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore përfituesit e pensionit të pleqërisë, që vetëpunësohen si të vetëm në sektorin privat.”

Sa më sipër, përfituesit e pensionit të pleqërisë, të cilët punësohen në subjektet private, duhet të deklarohen pranë organeve tatimore dhe të derdhin kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Ndërsa, punëdhënësi ka detyrimin ligjor të mbajë nga paga e të punësuarve kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe t'i derdhë ato tek organet tatimore, sipas Ligjit nr.

9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kontributet e derdhura gjatë periudhës në të cilën pensionistët përfitojnë pension nuk njihen si vjetërsi pune, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, dhe për rrjedhojë nuk merren parasysh për rillogaritjen apo rishikimin e masës së pensionit.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.